

OBJEKTI: RIKONSTRUKSIONI I KOPSHTIT “1 MAJI” DURRES



RELACION ARKITEKTONIK

Kopshti “1 Mji ” eshte nje objekt 2k i cili ndodhet ne lagjen nr 1, rruga “ Epikadeve ” .Pervec rikonstruksionit te kopeshtit do behet dhe sistemimi i territorit. Kopshti kufizohet ne veri, lindje dhe perendim nga objekte disakateshe dhe ne jug kufizohet nga rruge.

Siperfaqja e ndertimit eshte 316 m2.

Konceptimi i rikonstruksionit te kopshtit është bërë duke pasur parasysh nevojat per akomodimin femijeve . Gjithashtu rikonstruksioni i jep zgjidhje perfundimtare lageshtires ne dysheme dhe mure ne katin perdhe dhe lageshtires ne tavan ne katin e pare e cila vjen per shkak te mosfunksionimit te ulluqeve te shkarkimit. Catia e objektit do te priset dhe do te behet me solete (tarrace). Do te behet hidroizolimi I dyshemese me katrama, shtrese e cila do te vendoset edhe 50 cm ne mure ne katin perdhe si dhe hidroizolimi I tarraces me 2 shtresa katrama.

Objekti i kopshtit zhvillohet ne 2 kate. Ne plan ka forme drejtekendore dhe ne dy skajet mer forme te harkuar. Ne te dy katet jane vendosur nga dy grupe femijesh, wc, kuzhina dhe ambjentet e sherbimit te administrates dhe chillerit.

Ne katin perdhe eshte vendosur kuzhina, dhe ambjentet e grupeve te femijeve sebashku me wc dhe garderobat. Ne katin e pare do ndertohen drejtoria, salla e mbledhjeve dhe nje depo ne funksion te grupit te femijeve. Grupet e femijeve jane pothuajse identike Ne zgjidhjen planimetricke te grupit te femijeve eshte pasur parasysh ana funksionale e tij. Ambjentet jene te ndara sipas funksionit. Nga korridori i katit hyhet ne nje ambjent pritjeje qe sherben edhe si garderobe. Ai eshte i mobiluar me dollape per mbajtjen e rrobave te femijeve. Nga ky ambjent kalohet tek ambjenti i grupeve te femijeve i cili eshte dhe ambjenti me i rendesishim ku femijet kalojne pjesen me te madhe te

kohes. Ky ambient shërben gjithashtu edhe për fjetjen dhe ngrënjen e femijeve. Ky ambient ka dritë direkte dhe ajrim të drejtpërdrejtë. Lidhje direkte me këto ambiente kanë tualetet e femijeve. Funksioni i kopshtit përfshin ngrënien dhe fjetjen të femijeve dhe orari i qëndrimit të femijeve është nga ora 8:00 – 13:00 ose 8:00 – 16:00.

Nga korridori i katit kalohet në ambientet e femijeve, ky ambient ka sipërfaqe 120 m². Këto ambiente kanë dritë direkte dhe ajrim të drejtpërdrejtë. Të gjithë ambientet ajrohen e ndricohen në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Shkallet e kopshtit janë me 2 rampa dhe një sheshpushim në mënyrë që levizja e femijeve të jetë sa më komode. Bazamakët e shkalleve kanë lartësi 17cm, gjerësi 28 cm. Shkalla ka gjerësi 120 cm. Shkalla vishet me mermer të bardhë. Parapeti i shkallës është mur, do ruhet ai që është dhe do plotësohet me bazamakë mermeri.

Dera e hyrjes në kopsht është e dimensioneve 140x235. Banjat e femijeve janë të pajisura me 4 lavamanë dhe 4 WC. Ato do të shtrohen me pllakë porcelani importi dhe do të vishen me pllakë majolike deri në 1.5 m. Gjithashtu edhe kuzhina do të vishet me pllakë majolike deri në lartësi 1.7 m. Pllakat e dyshemese duhet të jenë jo të ilustruara për të shmangur rreshqitjen. Ndërsa të veshjes duhet të jetë të ilustruara për një higjienë sa më të mirë. Dhomat e fjetjes, të ngrënjes dhe lojrave të femijeve do të shtrohen me parket.

Ambjente të tjera do të suvatohen dhe do të lyhen me bojë hidromat ngjyrë të bardhë, do të shtrohen me pllakë importi. Lartësia e katit në objekt është 3.16 kati përde dhe 3.22 kati i parë nga dyshemeja në dysheme.

Dritaret e kopshtit do të jenë plastike dopjo xham me antiribalt (çdo dritare nga një antiribalt).

Dyert e zyrës, kuzhines, dhe të ambienteve të grupeve të femijeve janë të dimensioneve 90cmx200cm, të cilat do të jenë dyer druri.

Ngrohja dhe ftohja e ambienteve do të bëhet me radiatorë të cilët do të vendosen poshtë dritareve. Ngrohja do të realizohet me sistem ngrohje Chiller.

Fasada e objektit është trajtuar e thjeshtë. Ajo do të vishet me polisterol dhe do të krijohen forma sic është paraqitur në projekt. Polisteroli do të realizohet sipas detajit të treguar në projekt.

Me pas të japim të detajuar ambientet në çdo kat dhe sipërfaqet e shfrytëzueshme të tyre.

➤ Në katin përde gjendet:

dy grup për femije, dhoma e kaldajës, njëja h-sanitare, kuzhina, dhoma ku do vendoset kaldaja, ambientet lidhëse shkalle.


Grupi i parë ka një sipërfaqe të shfrytëzueshme 137 m² dhe përbehet nga këto ambiente.:


- Dhoma e femijeve 120 m²
- Njëja hidrosanitare ka sipërfaqe 7 m² dhe i shërben femijeve të grupit të parë.
- Garderoba ka sipërfaqe 10.4 m².

Grupet e tjera kanë të njëjtat permasa. Tarraca e kopshtit nuk do të jetë e shfrytëzueshme.

PAMJE NGA KOPSHTI









1. Llaçi

(Sasia per 1m³)

2.a Llaçi

2.a.1 Llaç bastard marka 15 me rërë natyrale lumi (me lageshti, shtese ne volum 20% dhe porozitet 40% e formuar me, çimento: gelqere: rërë ne raPortë 1: 0,8: 8. Gelqere e shuar lt 110 , çimento 300 kg 150 , rërë m³ 1,29 .

2.a.2 Llaç bastard marka 25 me rërë natyrale lumi (me lageshti, shtese ne volum 20% dhe

porozitet 40%) e formuar me, çimento: gelqere: rërë ne raPortë 1: 0,5: 5,5. Gelqere e shuar lt 92 , çimento 300 kg 212 , rërë m³ 1,22 .

2.a.3 Llaç bastard marka 15 me rërë të larë (porozitet 35%) e formuar me, çimento, gelqere, rërë ne raPortë 1: 0,8: 8. Gelqere e shuar lt 105 , çimento 300 kg 144 , rërë m³ 1,03 .

2.a.4 Llaç bastard marka 25 me rërë të larë (porozitet 35 %) e formuar me , çimento: gelqere, rërë ne raPortë 1: 0,5: 5,5. Gelqere e shuar lt 87 , çimento 300 kg 206 , rërë m³ 1,01 .

2.a.5 Llaç bastard marka 1:2 me rërë të larë (porozitet 35%) e formuar me çimento, rërë ne raPortë 1:2. Çimento 400 kg 527 , rërë m³ 0,89.

2.b Mur ndarës me tulla me vrima 12 cm

Murature me tulla me 6 vrima, me trashesi 12 cm dhe Llaç bastard m-25 sipas pikes 1.2, me dozim per m³ : tulla me 6 vrima nr.177, Llaç m³ 0,10, çimento 400 kg 14 dhe uje, perfshire çdo mjeshteri për dhembët e lidhjeve, qoshet, hapjet ne parapetet e dritareve, skelat e sherbimit dhe çdo gje tjeter te nevojshme per mbarimin e muraturës dhe realizimin e saj ne menyre perfekte. Per muraturen e katit perdhe siperfaqja e themelit duhet te jete e niveluar me nje Shtresë Llaçi çimento 1:2 me trashesi 2 cm.

3. BETONI

(Sasia per 1m³)

3.a. Punime betoni

3.a.1 Beton marka 150 me *inerte* , konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm, rërë e lare me modul 2,6: Çimento 400 kg 260 , rërë e lare m³ 0,44 , granil m³ 0,70, uje m³ 0,18.

3.a.2 Beton marka 200 me *inerte* , konsistence 3-5 cm, granil deri 20 mm, rërë e lare me modul 2,6: Çimento 400 kg 370 , rërë e lare m³ 0,43, granil m³ 0,69 , uje m³ 0,185 .

3.a.3 Beton marka 250 per sheshin e fushes se basketbollit do punohet me kuarc dhe helikopter.

Si dhe do kete zgare hekuri fi 6.

3.e Arkitrarë të derdhur në vepër

Arkitrarë ne te gjithë gjerësine e muraturës poshte me mbeshtetje prej 20 cm mbi shpatullat anesore, me lartësi te ndryshme sipas hapësires se drites, te armuar ne menyren te rregullt dhe sipas udhezimeve ne projekt, te formuar nga beton M-250 sipas pikes 3.a.5, duke perfshire skelat e sherbimit, kallepet perforcimet, hekurin e armatures dhe çdo detyrim tjeter per mbarimin e punes ne menyre perfekte.

4.TARRACE,HIDROIZOLUESE

4.a. TARRACA

4.a.1 Fillimisht do te behet prishja e izolimit ekzistues te tarraces, e cila me pas do te termoizolohet me polisterol $t=10$ cm. Ne tarrace do vendosen 2 shtresa katrama per hidroizolim e saj dhe do ti jepet pjerresi me beton 7 cm mbi polisterol. Hidroizolim me dy shtresa katrama do te behet dhe tek streha (penicilina). Tek tarraca e re qe do te ndertoht do te realizohet parapet i ri me lartesi 70 cm, ne te cilin do te vendosen cdo 4 ml kolloneta b/a monolitizuese M 200. Kollonetat do te armohen me hekur me diameter 10 cm me mbjellje. 4 shufra hekuri per cdo kollonete. Parapeti do te suvatoht brenda dhe jashte.

4.b Ulluke vertikale

Ulluke vertikale per shkarkimin e ujrave te tarraces i perbere me baker me dimensione \varnothing 120. Ne çdo ulluk duhet te mblidhen ujrata e nje sipërfaqe te tarracës jo me te madhe se 75 m² .

Ulluket duhet te vendosen ne pjesen e jashtme te nderteses me ane te qaforeve përkatëse prej celiku te xinguar

5. PUNIME DYSHEMEJE

5.a Prishja e shtresave te dyshemese dhe ndertimi nga e para

Do te behet prishja e pllakave ne katin e pare dhe ate perdhe, veshjet ne WC dhe kuzhine, si dhe prishja e shtresave poshte pllakave. Me pas dyshemeja e katit perdhe dhe banjot ne katin e pare dhe ate perdhe do te hidroizolohen me 1 shtrese mapei. Pervec ketyre hidroizolim do ti behet dhe mureve te brendshem ne katin perdhe deri ne lartesine 50 cm. Mbi hidroizolim me 1 shtrese mapei do te vendoset shtrese niveluese e lehtesuar stirobeton 7 cm dhe ne fund shtrimi me pllaka dhe parket i dyshemese se kateve.

5.c Hidro - izolim i dyshemeve

Shtresë hidro-izolimi per te gjitha dyshemete dhe muret e brendshem deri ne lartesine 50 cm te katit perdhe si dhe të banjove te dy kateve, e perbërë nga 1 shtrese mapei.

5.d Dysheme me pllaka importi

Pllakat do te jene importi. Ngjyra e tyre do te percaktoht nga projektuesi. Pllakat do te jene «zgjedhje e pare» te verifikuara ne ambalazhim. Pllakat do te shtrohen me kolle, mbi nje sipërfaqe grezo me llaç çimento pasi te jete verifikuar nivelimi i saj me nje proces verbal. Nivelimi te behet nga nje specialist topograf me nje tolerance jo me shume se 5mm ne te gjithe godinen. Shtrimi me pllaka do te behet do te behet ne kuzhine, dhomen e kaladajes, wc, korridor dhe depot e katit perdhe si dhe ne drejtorine , korridorin, depot e katit te pare. Veshja ne wc dhe kuzhine do te behet me pllaka majolike .

5.e Dysheme me parket laminat

Shtrimi me parket laminat $t = 12$ mm do te realizohet ambjentet e femijeve te katit perdhe dhe te katit te pare. .Ngjyra e tyre do te percaktoht nga projektuesi. Laminati do te jene «zgjedhje e pare» te verifikuara ne ambalazhim.

6. Punime suvatimi

6.a Suvatim i brendshëm dhe i jashtëm

Sprucim i mureve , me Llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe rforcimin e sipërfaqeve të muraturës, duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për të dhënë plotësisht fund sprucimit.

Suvatim i realizuar nga një shtresë me trashësi 2 cm Llaçi bastard m-25 me dozim për m² : rërë e lare m³ 0,005, Llaç gelqereje m-1:2 m³ 0.03, çimento 400 kg 6.6, uje, i aplikuar, me paravendosje të drejtuesve në mure, dhe e lëmuar me mistri e berdaf, duke përfshirë skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për të dhënë plotësisht fund suvatimit në mënyrë perfekte.

7. Punime bojatisje

7.a Bojatisje me bojra plastike dhe hidroplastike

Lemim i suvasë së re me parë me letër zmerile nr.40 ose nr.60 dhe me pas stukum me stuko sintetike në pjesët ku ka nevojë për të patur të gatshme dhe në mënyrë perfekte sipërfaqet për lyerje.

Me pas pasi pastrohet nga pluhuri i behet astarimi me astare të gatshme me baze akrilike ose plastike sipas tipit të bojës që do të përdoret ,ose në rast të vecanta përgatitet një dorë e formuar me rreshirë të hollë me 50 % ujë dhe e zbatuar me penel ose rulon mbi mure dhe tavane. Bojatisje në dy duar me bojë në një distancë kohe të nevojshme për tharje të dorës së parë. Siperfaqja të jetë uniforme dhe pa njolla. Ngjyrat e bojës do të përcaktohen nga projektuesi.

8. Punime të ndryshme

8.a Dyer dhe dritare

Dyert dhe dritaret me të gjitha elementet dhe detajet e tyre do të përcaktohen nga projektuesi.

9. Punime Sistemimi

9. c Shtrim me pllaka betoni rreth e q ark kopeshtit

Pllakat do të jenë veteshtrenguese prej betoni dhe do të vendosen në të gjithë territorin e oborrit të kopshtit pa hequr përveç ekzistuesve të kopshtit. Në oborrin përpara të kopshtit do të vendoset një kune betoni për mbledhjen e ujërave të shirave cila do të lidhet me një pusëtë shi mbledhëse(KUB)

➤ Punime elektrike

FURNIZIMI ME ENERGJI

- ambientet e kopeshtit do te furnizohen me energji elektrike nepermjet paneleve te matjes se perqendruar te energjise PM . Ne keto panele montohen matesit e perqendruar te energjise si dhe automatet termomagnetike per mbrotjen e linjave per secilin ambiente.
- Vlera e rezistences se tokezimit te punes duhet te jete $\leq 4 \Omega$
Shenim : Sipas normes se sigurimit teknik te vendit tone , percjellesi i nulit te çdo paneli duhet te lidhet me percjellesin e tokezimit te punes . Ne rastin tone per bllokun eshte parashikuar tokezim pune i veçante.

- Furnizimi i kuadrove elektrike (KE_A) nga panelet respektive, do te realizohet me kablllo te tensionit te ulet me izolacion PVC te tipit **FROR 5x10 mm²** edhe kuadri kuzhines. . Keto kablllo jane kunder djegjes me flake dhe montimi i do te realizohet nepermjet shtrirjes se tyre ne sipërfaqen vertikale te kafazit te shkalleve ku eshte vendosur pareti teknik

Menyra e montimit te linjave te prizave dhe çelsave paraqiten grafikisht ne nje flete vizatimi te veçante

Poshte kuadrit elektrik te ambienteve montohet nje kasete PVC e madhesise **PT7** ne lartesi 40 cm nga dyshemeja per shperndarjne e linjave elektrike. Keto linja jane me percjellsa te standartit NO7V-K , te futura ne tubo fleksibel PVC te forte $\Phi 25\text{mm}$.

Rrjeti elektrik qe furnizon prizat realizohet me percjellsa tip **NIVV-K 1 x 2.5mm²** , ndersa per rrjetin e prizave te kondicionereve , lavatriçes etj do te realizohet me percjellsa tip **NIVV-K 1 x 2.5mm²**.

Te gjithë percjellsat do te mbrohen me tubo PVC , fleksibel tip i rende $\Phi 25$ mm qe shtrihen nen pllakat e dyshemese se apartamentit .

Linja e ndricimit te ambienteve te kopeshtit nga kuadri elektrik ne çelesat e ndricimit do te realizohen me percjellsa te tipit **NO7V-K ne seksion 2x (1x1.5)mm²** te futur ne tubo PVC te forte fleksibel $\Phi 16$ mm.

Linja e ndricimit nga çelasi i komandimit ne abazhur do te realizohen me kabell te tipit NO7-K me seksion 3x1.5mm² i futur ne tub fleksibel te rende $\Phi 16\text{mm}$ ne pjesen vertikale te murit, ndersa ne pjesen tavanore kablli futet ne tub $\Phi 16\text{mm}$ ne suva. Ndricimi i shkalleve komandohet nga nje automat tip "Finder".Shuarja dhe ndezja e dritave realizohet ne cdo shesh pushim te shkalleve me ane te pulsanteve te komandimit .

Lartesite e vendosjes se paisjeve mbi dysheme e mbaruar:

1. Celsat e ndricimit 0.9-1.5m
2. Prizat 02.-0.4m,

- 0.7 m kur jane mbi komodinat

- 1.2 kur jane mbi banak te bufese se gatimit
 - 1.5 m kur jane mbi tavolinat e punes,
 - 1.8 per boilerin
 - 2.2 m per kondicioneret,
 - 1.2 m per lavatricet.
3. Dalje drite murale 1.75m
 4. Kuadri elektrik i apartamentit 1.7m (aksi i mesit i kuadrit)
 5. Prizat e telefonise 0.4m. Prane cdoprize telefonie e TV vihet nje prize bivalente 10A

Instalime elektrike mund të bëhen në dy mënyra:

- Nën suva të futura në tuba PVC fleksibël
- Mbi suva në kanaleta PVC

Aksesorët e instalimeve nën suva janë :

- Tubat fleksibël PVC të dimensioneve të ndryshme në varësi të dimensionit dhe të numrit të telave që do të futen në të
- Kutitë shpërndarëse


Kutitë për fiksimin e prizave ose të çelësave

Të gjitha këto vendosen para se të bëhet suvatimi.

2) Llambat dhe ndriçuesit

Ndricimi neper klasa te jete 300 lx sipas standarteve.

Pozicioni i ndriçuesve duhet të jetë si ai i treguar në projekt skicën e Inxhinierit Elektrik. Instalimi i ndriçimit do kryhet duke përdorur kabllot e izolimit PVC, tipi NYN, që kalojnë brenda tubit fleksibël PVC, në përgjithësi të fshehura brenda suvasë së ndërtesës ose në kanaleta kur përdoret sistemi i kanalave.



● SHKARKIMET ATMOSFERIKE

Duke qene se zona ku do te ndertohet kjo godine eshte e predispozuar nga goditjet e shkarkimeve atmosferike , rrjeti per kete mbrotje eshte llogaritur sipas normes se nivelit te pare te mbrotjes .

Per kete qellim ne projekt eshte shfrytezuar taraca e godinave ku krijohet nje rrjete ekuipotenciale e cila do te kete 2 zbritje. Rrjeta krijohet me shirit FeZn dhe vendoset poshte shtresave izoluese te taraces. Zbritjet realizohen me shirit FeZn dhe lidhen me sistemin e elektrodave te shkarkimit nentoke. Per kontrollin e tokezimit do te realizohet nje dalje e veçante e cila do te sherbeje per kontrollin periodik te matjes se tokezimit .

Nese vlera e tokezimit te kontolluar do te rezultojte me e madhe se **4 Ω** atehere do te shtohet nje tokezim suplementar ne perputhje me skicat e tregura ne projekt.

● TOKEZIMI MBROJTES DHE I PUNES

Duke qene se sistemi i furnizimit me energji elektrike eshte 10/ 20 kV , tokezimi i mbrojtjes do te jete i njejte me tokezimin e punes .Pra buloni i nulit te transformatorit do te lidhet me percjellesin e tokes . Keshtu :

- Per objektin eshte parashikuar tokezimi mbrojtjes prane se . Ky tokezim llogaritet ne vleften $R_{tokes} \leq 4 \Omega$, dhe lidhet me zbaren e nulit te te rrjetit .
- Tokezimi i punes realizohet prane cdo shkalle me ane te se cilit nga panelet perkatese . tokezohet percjellesi i nulit te kabllave furnizuese te prizave .
- Nese nuk realizohet vlefte e $R_{tokes} \leq 4 \Omega$, me numurin e elektrodave te paraqitura ne projekt , atehere duhet te realizohet tokezim artificial, duke perpunuar vendin ku do te behet tokezimi.
-

• DETAJE PER NDRICUESIT

Tavanor

18W

- Fuqia : 18 W
- Jo me pak se 1800Lm
- 4000K
- Tensioni : 230V
- LED IP20



Tipi : Ndricules LED , dimesion 225x200mm x20mm (ose Ekuivalente)

- Fuqia : 18 W
- Jo me pak se 1800Lm

- 4000K
- Tensioni : 230V
- LED IP20
- Mënyra e lidhjes me rrjetin : Në rrjet
- Lloji i ndriçimit : sa me afer natyrales
- Ambiente të brendshme/ të jashtme : Të brendshme
- Materiali : Alumin /PC /PET
- Jetegjatesia: jo me pak se 50000 ore pune

Ndricues led 2x17 w .

Të gjithë ndriçuesit do te jene LED:(ose ekuivalente)



en
curement
bania

- Tipi : Ndricues tavani
- Fuqia : 2x17w
- 3000 Lm
- 3900K
- Tensioni : 230V
- Mënyra e lidhjes me rrjetin : Në rrjet
- Lloji i ndriçimit : sa me afer natyrales
- Reostat : Jo
- Përfshin llambat : Po
- Ambiente të brendshme/ të jashtme : Të brendshme
- Materiali : Qelq/metal
- Shkalla e mbrojtjes (IP) : IP40

Ndricules Prozhektor LED per ndricimin e jashtem te territorit te kopeshtit (ose Ekuivalent)



- Fuqia : 100 W ,
- IP 65
- Eficensa 80 lm/wat, 8000 Lm
- Diametri:
- Tensioni : 220-240V
- Lloji i llambave : Led
- Lartesia :
- Lloji i

ndricimit : sa me afer naturale 4000-6400K

- Mënyra e lidhjes me rrjetin : Në rrjete

11.PUNIME HIDRAULIKE

11.a Impianti i furnizimit me uje dhe kanalizimet

Impianti hidraulik dhe kanalizimet duhet te ndertoht sipas :

- permasave, markes, karakteristikave dhe cilesise se materialit te treguar ne projektet e hartuara;
- udhezimeve te D.P. gjate kryerjes se puneve ;

- respektimit të ligjeve në fuqi ;

Materialet dhe aparatet që janë për tu përdorur në ndërtimin e impiantit duhet të kenë të gjitha cilësitë e fortësisë, kohezgjatësisë, izolimit dhe të funksionimit të mirë; dhe duhet gjithashtu të jenë të tilla që të rezistojnë veprimeve mekanike, gërryese, termike dhe lageshtisë për ato që duhet të jenë në kontakt me të gjatë punës. Gjithashtu, janë nën përgjegjësinë e sipërmarresit montimet dhe cmontimet përkatëse të pjesëve të instalimit për realizimin e provave dhe të verifikimeve.

Tubacionet që futen nën tokë, duhet të vendosen nga plani i tokës ose dyshemeja në një thellesi:

- për impiantin e furnizimit me ujë hidraulik në 100 cm;

- për impiantin e kanalizimit të ujërave të zeza sipas pjerresisë së terrenit, por minimumi në 100 cm.

Tubat duhet të vendosen në vepër pas Gërmimit të dheut, mbi rërë në lartësinë 7 cm. Mbushja e Gërmimit duhet të bëhet pa levizur sadopak tubat e vendosur në vepër duke ngjeshur rreth tyre dheun që ka rezultuar nga Gërmimi.

Tubacionet e mbyllur në muraturë ose të mbështetura në Soletë duhet të mbrohen nepermjet veshjeve të pershtatshme dhe të fiksohen në mënyrë perfekte.

Të gjitha lidhjet, për tubacionet e brendshme, të jashtme dhe natyrale të ndryshme duhet të kryhen në mënyrë të mos rrjedhin si gjatë dhe nga përdorimi ashtu dhe nga ndryshimet e temperaturës ose nga shkaqe të tjera.

Për ankorimin e mbështetës, ganxhave, mberthyesëve, takove, etj..., për lidhjet në mur e për mbështetjen e paisjeve sanitare duhet të përdoret Llaç çimentoje m-1:2, sipas pikës 3.a.5.

Është absolutisht e ndaluar përdorimi i Llaçit me allci ose të lendeve të tjera të tilla për vendosjen në vepër të stafave etc..., mbylljen e kanaleve dhe të çdo punimi tjetër murature që është i nevojshëm për impiantin.

Në pikën e takimit të tubit të ujit me atë të rrjetit të kanaleve të zeza, është absolutisht e nevojshme që tubi i ujit të jetë i futur në një kemishe hekuri të bitumuar me d.100 mm për një gjatësi prej 3 m dhe i mbuluar me beton në të dy ekstremet.

Në vendosjen në vepër të aparaturave higjieno-sanitare, të rubinetave, përveç të gjitha Punime të muraturës, pa përjashtim, është parashikuar edhe furnizimi me materiale konsumi për të bërë paisjet e montuara sa më efektive dhe funksionuese në çdo pjesë të tyre.

Tubacioni i ujit, sipër atij të kanaleve të zeza, duhet të jetë i distancuar sipas rregullave teknike.

Grupi i projektimit.

Ark. Adnand Tocila

Ing. Bora Hysi

Ing.elek. Mariglen Jahollari

